



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Durrës, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2020

**PROJEKTVENDIM**

**NR. \_\_\_\_\_, DATË \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2020**

**PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA TË AMBJENTIT ME VENDODHJE NË KATIN ZERO TË NDËRTESËN ME NR. PASURIE 5/109, ZK 8516, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 585.2 M<sup>2</sup> (NGA KJO SIP. NDËRTIMI 555 M<sup>2</sup> DHE SIP. FUNKSIONALE 30.2 M<sup>2</sup>), NË INVENTAR TË NDËRMARRJES TREGTISË ME SHUMICË (BGT), PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT 3 (TRE) VJET, NËPËRMJET PROCEDURËS SË KONKURRIMIT**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 536, datë 01.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, VKM-së nr. 54, datë 05.02.2014 “ Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, shkresës së ardhur nga Ndërmarrja Tregtisë me Shumicë me nr.02/7 prot., datë 02.07.2020, me kërkesë “Dhënie me qira të ambjentit për efekt të mbarimit të kontratës”, nenit 801-825 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë “Për Qiranë”, sipas Relacionit të përgatitur nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, zëvendëskryetari i Bashkisë, i propozon Këshillit Bashkiak,

**PËR TË VENDOSUR:**

1. Miratimin për dhënie me qira të ambjentit me vendodhje në katin zero të ndërtesën me nr. pasurie 5/109, ZK 8516, me sipërfaqe të përgjithshme 585.2 m<sup>2</sup> (nga kjo sip. ndërtimi 555 m<sup>2</sup> dhe sip. funksionale 30.2 m<sup>2</sup>), në inventar të Ndërmarrjes Tregtisë me Shumicë (BGT), pronë e Bashkisë Durrës, për një afat 3 (tre) vjet, nëpërmjet procedurës së konkurrimit.

2. Ngarkohet Drejtoria Ligjore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

**PËR DREJTORINË LIGJORE  
ZËVENDËSKRYETAR I BASHKISË**

**Florian Tahiri**

**PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE  
DHE PUNËVE PUBLIKE**

**Ardian Iljazaj**

**ZËVENDËSKRYETAR I BASHKISË**

**Emiriana Sako**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Durrës, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2020

**RELACION**

**MBI MIRATIMIN PËR DHËNIEN ME QIRA TË AMBJENTIT ME VENDODHJE NË KATIN ZERO TË NDËRTESEN ME NR. PASURIE 5/109, ZK 8516, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 585.2 M<sup>2</sup> (NGA KJO SIP. NDËRTIMI 555 M<sup>2</sup> DHE SIP. FUNKSIONALE 30.2 M<sup>2</sup>), NË INVENTAR TË NDËRMARRJES TREGTISË ME SHUMICË (BGT), PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT 3 (TRE) VJET, NËPËRMJET PROCEDURËS SË KONKURRIMIT**

**PARA KËSHILLIT BASHKIAK**

**KËTU**

**Të nderuar këshilltarë!**

Projektvendimi që po ju paraqesim për miratim ka për qëllim fillimin e procedurave për dhënie me qira, nëpërmjet procedurës së konkurrimit, të ambjentit, e ndodhur në ndërtesën me nr. pasurie 5/109, ZK 8516, me sipërfaqe të përgjithshme 585.2 m<sup>2</sup> (nga kjo sip. ndërtimi 555 m<sup>2</sup> dhe sip. funksionale 30.2 m<sup>2</sup>), në inventar të Ndërmarrjes Tregtisë me Shumicë (BGT), pronë e Bashkisë Durrës, për një afat 3 (tre) vjet e kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës me VKM –së nr. 536, datë 01.05.2008, për t’u përdorur për ushtrimin e funksioneve të veta.

Ky ambjent i është dhënë në përdorim, me kontratë qiraje një subjekti, kontratë e cila ka mbaruar me datë 03.04.2020 dhe për shkak të pandemisë ka vazhduar ecurinë me kushtet e kontratës së mëparshme, kjo dhe si një përcaktim që i bën neni 821 e vijues i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Rezulton se në adresë të institucionit të bashkisë ka paraqitur kërkesë Ndërmarrja Tregtisë me Shumicë për dhënie me qira të ambjentit objekt shqyrtimi nga ana juaj, për efekt se ka mbaruar kontrata.

Nisur nga fakti se sipërfaqja e këtij ambjenti që kërkohet të merret me qira është mbi 200 m<sup>2</sup>, të drejtën për t’u shprehur si për dhënie me qira, ashtu dhe për afatin e përdorimit 3 vjet, e ka këshilli bashkiak, ndaj i drejtohem i këtij Këshilli për t’u shprehur me vendim. Këtë të drejtë e jep VKM-ja nr. 54, datë 05.02.2014 “ Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, i cili përcakton se “... Pasuritë shtetërore u jepen të tretëve, duke u transferuar të drejtën e përdorimit me qira ose enfitozë, nëpërmjet procedurës së konkurrimit... Pasuritë shtetërore, që jepen me qira janë: ndërtesat, sipërfaqet funksionale (jo nën

ndërtesë), trualli i lirë... Organi, që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore jep me qira deri në 20 vjet sipërfaqe mbi 200 m<sup>2</sup>.

Ndërsa ligji organik i vetëqeverisjes vendore në paragrafin *për të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë* përcakton se "... njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrjnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrjnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj...".

Neni 54 i ligjit "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak", gërma "e", përcakton se Këshilli bashkiak "... miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve... Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit...".

Ndodhur në këto kushte, me qëllim sigurimin e të ardhurave për bashkinë, i kërkojmë Këshillit Bashkiak që të shprehet me vendim për miratim për dhënien me qira të pronës në fjalë.

#### **Dhënia me qira e pasurisë të sipërcituar zgjidh këto probleme:**

- Minimizon sadopak papunësinë.
- Shton të ardhurat në buxhetin e bashkisë dhe të ndërmarrjes.
- Përmirëson objektin nga investimi i pritshëm që do të kryhet nga subjekti gjatë ushtrimit të aktivitetit.
- Ruan objektin nga degradimi ( shkatërrimi ) si rezultat i mospërdorimit.

#### **Bashkëlidhur relacionit aktet e mëposhtme:**

- Planrilevimi i pasurisë që kërkohet të jepet me qira.
- VKM-ja nr. 536, datë 01.05.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të Bashkisë Durrës, i ndryshuar, së bashku me formularin.
- Vertemi hipotekor nr. regjistri hipotekor 34, datë 02.06.2009.
- Shkresa e ardhur nga Ndërmarrja Tregtisë me Shumicë (BGT), që mban nr. 02/7 prot., datë 02.07.2020.

**SEKTORI I PRONAVE PUBLIKE  
DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE  
Irma Bushi**

**Konc. Juristi Aleks Prenga e Silvana Shehu**